

URDHËR
Nr.193/2, datë 14.5.2020

**PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR. 193, DATË 20.3.2020 “PËR MBYLLJEN
APO KUFIZIMIN E LËVIZJEVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË“, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të neneve 7, pika 4 dhe 15, të ligjit nr. 15/2016 “Për parandalimin dhe liuftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të ndryshuar, si edhe në zbatim të udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, në vijim të shkresave të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 2470, prot, datë 29.4.2020 dhe nr. 2604, datë 8.5.2020,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr. 193, datë 20.3.2020 “Për mbylljen apo kufizimin e lëvizjeve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhet ndryshimi si vijon:

1. Në listën bashkëlidhur këtij urdhri bëhet ndryshimi si më poshtë vijon:

126	ARSIMIMI Vetëm institucionet e arsimit parauniversitar, të përcaktuara nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë për zhvillimin e procesit mësimor dhe provimeve të Maturës Shtetërore në datat e vendosura nga kjo ministri.	LEJOHEN
-----	---	---------

2. Institucionet arsimore të përcaktuara në pikën 1 të këtij urdhri do të ushtrojnë veprimtarinë në zbatim të protokolleve të miratuara për “Masat ndaj COVID-19”, që duhet të ndër marrin institucionet arsimore.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu